



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 645/1 Prot.

Tiranë, më 18. 06. 2018

V E N D I M

Nr. 139, Datë 18. 06. 2018

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 61, datë 11.05.2018, e shtetasit G. H., kundër Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimit Social Shtetëror, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

G. H. sqaron se familja e tij është e përbërë nga 3 (tre) anëtarë. Të ardhurat e vetme mujore që i sigurohen nga shteti shqiptar, janë ato që përfiton nga skema e ndihmës ekonomike në shumën 3960 lekë të reja në muaj. Sipas tij, kjo shumë nuk i plotëson as kërkesat minimale të jetesës për familjen e tij, duke qënë se vetëm faturat e energjisë elektrike dhe ajo e ujit shkojnë mesatarisht 3600 lekë në muaj. Gjatë periudhës që është trajtuar me pagesën e ndihmës ekonomike, pretendon se edhe pse është i rregjistruar si punëkërkues i papunë, nuk i është ofruar asnjë vend pune nga ana e Zyrës së Punës. Gjithashtu, familja e tij është e rregjistruar pranë Bashkisë Elbasan, si familje e pastrehë. Në vijim ankuesi shprehet se, referuar raportit të Avokatit të Popullit të vitit 2016 për minimumin jetik, çdo njeri ka nevojë për një shumëllojshmëri produktesh ushqimore, një numër minimal artikujsh jo-ushqimor dhe një numër minimal shërbimesh të nevojshme për të përmbushur nevojat bazë sociale dhe kulturore. Për të përballuar këto shpenzime, ndihma ekonomike prej 3960 lekë në muaj nuk mjafton.

Në përfundim ankuesi sqaron se mospërcaktimi me ligj i minimumit jetik në Shqipëri bën që familja e tij të trajtohet në një masë tepër të ulët të ndihmës ekonomike, e pamjaftueshme për të plotësuar nevojat bazë, si dhe vendos familjen e tij në kushte të pabarabarta me të tjerët duke mos i ofruar jetë dinjitoze me të tjerët.

Në këto kushte, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: *“Hetimin e plotë të çështjes, konstatimin e diskriminimit nga ana e Këshillit të Ministrave, Ministrisë së*

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimit Social Shtetëror, sepse me anë të mospërcaktimit të nivelit të minimumit jetik trajtohet me ndihmë ekonomike në masën që nuk plotëson nevojat bazë të jetës.”

Në këto kushte, pas analizimit të ankesës nr. 61, datë 11.05.2018, Komisioneri konstatoi se:

Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë provë apo indicie, lidhur me trajtimin në mënyrë më pak të favorshme apo diskriminuese, në raport me të tjerë në një situatë të ngjashme dhe ky trajtim të ketë ardhur për shkakun që ankuesi pretendon.

Pretendimi i ankuesit për trajtimin diskriminues të tij, lidhet me faktin se masa e ndihmës ekonomike është tepër e ulët në raport me kërkesat e çdo familje që sipas tij duhet të trajtohet me ndihmë ekonomike dhe nuk lidhet me një cilësi apo specifikë të veçantë të ankuesit, për të cilën ai trajtohet në mënyrë të pabarabartë nga persona të tjerë të cilët janë përfitues të ndihmës ekonomike.

Përsa më lart dhe mbështetur në parashtrimet e bëra në ankesën e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ankuesi ka ngritur një problematikë që prek një numër të madh dhe të papërkufizuar personash dhe jo vetëm atë si individ, e cila nuk lidhet drejtëpërdrejtë me trajtim të pabarabartë dhe diskriminues të subjektit ankues.

Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 33, pika 4/ç të tij, parashikon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*.

Në përfundim, duke analizuar në tërësi ankesën nr. 61, datë 11.05.2018, të G. H., Komisioneri gjykon se, në rastin konkret ankesa bie ndesh me kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, e në këto kushte në mungesë të informacionit të mjaftueshëm ajo nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 12, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 61, datë 11.05.2018, e G. H., pasi ankesa nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja ekonomike)
(Fusha: Shërbime)